

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

MBLEDHJE BORDI

Gjatë muajit prill Bordi i ERE-s ka zhvilluar 4 mbledhje, që kanë rezultuar në 32 vendimmarrje, që lidhen me autritetin e ERE për dhënien, rinovimin, modifimin e licensave, me dhënien e garancive të origjinës për energjinë e prodhuar nga burimet e rinovueshme, si dhe për përcaktimin e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike, për kateogri të caktuara konsumatorësh. Në kuadër të shqyrtimit të kërkesave sipas fushave të përgjegjësië si më sipër disa nga vendimmarrjet e ERE përfshijnë:

- Licencimin e shoqërisë "Protergia Energy Albania" sh.p.k.në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, rinovimin e licencës për shoqërinë "ECO-ELB" sh.a., licencimin e shoqërisë "DRINI BULQIZE" shpk, si dhe mospranimin e kërkesës së shoqërisë "Teodori" shpk, në të treja rastet për licencimin në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike; fillimin e procedurës shoqërisë "HYDROBORSH" shpk dhe dhënien e autorizimit për vendosjen e kuotave si mjet për garantimi për shoqëritë Truen" sh.p.k. dhe Wenerg" sh.a, si dhe ndryshime në disa vendimmarrje si rezultat i plotësimit të kushteve të paravendosura, me të cilat mund të njiheni duke shfletuar faqen tonë zyrtare.
- Dhënien e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga impianti fotovoltaik në Digën e Qyrsaqit, HEC "Vau i Dejës" si dhe Hec "Bistrica 1", "Bistrica 2", Hec "Shkopet" dhe Hec "Ulëz", të shoqërisë "Kurum International" sh.a.

SEANCA DËGJIMORE

Gjatë muajit mars, pjesë e aktivitetit të ERE-s kanë qënë dhe pesë seanca dëgjimore me subjekte të licencuar, konsumatorëdhe palë interesi, dy nga të cilat zhvilluar me qëllim sqarimin e kërkesave të shoqërive, ose plotësimin e kushteve të paravendosura në vendimmarrjen e ERE-s; si dhe dy të të zhvilluara për zgjidhjen e ankesave apo marrjen e qëndrimeve të palëve me qëllim një vendimmarrje më të plotë.

Ndër to mund të përmendim gjithashtu seancën dëgjimore të zhvilluar me përfaqësues të Shoqatës së Prodhuesve të Bukës, MIE, OSHEE sh.a. dhe FSHU sh.a., në kuadër të procedurës së hapur në datë 02.04.2024 nga ana e ERE-s për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për kategorinë e klientëve "furra buke dhe/ose prodhim mielli" të lidhura në nivelin e tensionit 0.4 kV. Ky proces u finalizua me vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 72 datë 15.04.2024.

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

VENDIME

Vendimarrjet në kuadër të përcaktimit të çmimeve të energjisë elektrike përfshijnë:

1. Miratimi i çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për vitin 2024, prej 9.33 lekë/kWh për Shoqëritë Ujësjellës Kanalizime të lidhura në nivelin e tensionit 35 kV si dhe prej 11.77 lekë/kWh për Shoqëritë Ujësjellës Kanalizime të lidhura në nivelet e tensionit 20/10/6 kV.
2. Miratimi i çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për periudhën 01.01.2024 – 31.12.2024, prej 18.26 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV.
3. Miratimi i çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin Shkurt 2024 prej 11.83 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.
4. Miratimi i çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët Furra buke/Prodhim mielli që do të aplikohen nga FSHU sh.a. për periudhën 1 Maj 2024 – 31 Dhjetor 2024, sipas kategorive në vijim:

Kategoria I - Vetëm Furra Buke/Prodhim mielli - çmimi i shitjes së energjisë elektrike 7.6 lekë/kWh

Kategoria II - Furrë Buke, produkte mielli shoqëruese, pastiçeri - çmimi i shitjes së energjisë elektrike 9.5 lekë/kWh;

Kategoria III - Furrë Buke, Produkte Mielli shoqëruese, Pastiçeri, shërbim Kafe (ekspres) - çmimi i shitjes së energjisë elektrike 12 lekë/kWh;

5. Miratimi i çmimin e shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin Mars 2024 prej 11.07 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.

6. Miratimi i “Listës së Tarifave të ALPEX” të cilat do jenë të aplikueshme për Operatorin e Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), deri më 31.08.2024.

7. Për tu njohur me këto vendime dhe të tjera, në mënyrë më të detajuar, ju ftojmë të vizitoni faqen tonë zyrtare www.ere.gov.al në kategorinë [vendime](#).

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

AKTIVITETE

Pjesmarrje në workshopin “Bazat e një komunikimi efektiv për një ent publik në sektorin e energjisë” organizuar nga ERA në Baku, Azerbajxhan.

Përfaqësues të Entit Rregullator të Energjisë, znj. Tavani, Komisionere në Bordin e ERE-s së bashku me znj. Sinani, Specialiste e marrëdhënieve me publikun dhe median, patën kënaqësinë të merrnin pjesë në trajnimin e organizuar në Baku nga ERA, nën mikëpritjen e Rregullatorit të Energjisë për Azerbajxhanin. Gjatë aktivitetit u diskutuan teknikat më të mira të komunikimit në informimin e publikut të gjërë, duke patur në fokus vendimmarrjen e rregullatorëve të energjisë. Për këtë qëllim u ndanë gjithashtu eksperiencat dhe raste konkrete nga kolegët e Gnerc – Rregullatori Gjeorgji, PUC Rregullatori Lituanian, ERC Rregullatori në Maqedoninë e Veriut dhe RAAEY Rregullatori Greq. Rëndësi të veçantë ju dha transparencës, përshtatjes së informacionit për audiencën dhe zgjedhjes së strategjisë dhe kanaleve të duhura për shpërndarjen e informacionit dhe përfitim të opinionit të palëve të interesit. Gjatë diskutimit të hapur, u fol gjithashtu mbi praktikatat më të mira të komunikimit për aktualitete si tranzicioni i energjisë si dhe paqëndrueshmërinë e tregut të energjisë.

Takimi i G7 në kuadër të javës së Planetit, event pjesë e takimit të Ministrave Energjisë, Klimës dhe Mjedisit të vendeve të G7

U zhvillua në datën 24 prill 2024 në Torino takimi i #G7 në kuadër të javës së Planetit, event pjesë e takimit të Ministrave Energjisë, Klimës dhe Mjedisit të vendeve të G7. Në panelin me temë "Qytete inteligjente: urbanizimi i qëndrueshëm dhe dixhitalizimi si paradigma për arritjen e net zero të emetimit të karbonit" drejtuar nga GSE Itali, ishte i ftuar dhe Z. Elton B. Radheshi, Sekretari i Përgjithshëm në #ERE së bashku me z. Lamine Zitouni, përfaqësues i MEDREG, z. Salvatore Lanza përfaqësues i #ARERA, dhe z. Dhimitër Kote përfaqësues i OSSH sh.a. për të dhënë një

perspektivë të Rregullatorit mbi sfidat e tranzicionit energjetik mbi energjitë e rinovueshme, qyteteve inteligjente, makinave elektrike dhe dekarbonizimit, rolin të ERE-s në këto procese në Shqipëri dhe me gjërë në rajon si dhe bashkëpunimit me Rregullatorët e tjerë në kuadër të iniciativave të përbashkëta si Shkolla Ballkanike e Energjisë apo dhe Medreg ku ERE ka tashmë një rol të rëndësishëm.



NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË



Mbi vizitën e përfaqësuesve të CRE në Ambientet e ERE në Tiranë më 24, 25 dhe 26 Prill

Në datat 24, 25 dhe 26 Prill 2024 u mirëpritën në ambientet e ERE-s përfaqësuesit e CRE – Komisioni Rregullator i Energjisë në Francë, në bashkëpunim me Expertise France, me qëllim shkëmbimin e eksperiencave dhe në kuadër të bashkëpunimit midis dy Enteve Rregullatore. Gjatë aktivitetit, fillimisht pjesmarrësit u njohën me një përshkrim të përgjithshëm të ERE-s, dhe objektivat e institucionit për ruajtjen e energjisë si dhe u prezantua një këndvështrim i funksionimit



të CRE, përvojës, teknologjive që përdorin për ruajtjen e energjisë dhe sfidat që has ky proces. Pjesmarrësit diskutuan gjërësisht mbi tematika si një vështrim i përgjithshëm i tregjeve evropiane balancuese; kapaciteti dhe tregjet e energjisë; kuadri rregullator francez lidhur me balancimin e tregjeve; praktikat më të mira në lidhje me ruajtjen e energjisë elektrike - aspektet e rrjetit; tarifa për shfrytëzimin e rrjetit publik të energjisë elektrike; ruajtja e energjisë elektrike si zgjidhje për bllokimet lokale; praktikat më të mira në lidhje me ruajtjen e energjisë elektrike si dhe raste konkrete studimore të sjella nga kolegët francezë.

